

RAPORTI I DYTË
GJASHTËMUJOR
I MONITORIMIT

**MONITORIMI
I ZBATIMIT
TË STRATEGJISË
PËR REFORMËN
NË SEKTORIN
E DREJTËSISË
2017 - 2022**

PERIUDHA E MONITORIMIT:
JANAR - QERSHOR 2022




БЛУПРИНТ ГРУПА
за реформи во правосудството





Përmbajtja

HYRJE	3
I. Pjesëmarrja (Përfshirja)	6
II. Transparenca	8
III. Afati kohor	11
IV. Cilësia	11
V. Ndikimi mbi të drejtat e njeriut dhe drejtësinë sociale	13
RRETH PROJEKTIT	15



HYRJE

Viti 2022 është viti i fundit në të cilin zbatohet *Strategjia për Reformën në Sektorin e Drejtësisë 2017-2022*¹ (në tekstin e mëtejme: *Strategjia*). Përderisa disa nga masat dhe aktivitetet e planifikuara tashmë janë zbatuar, veçanërisht ato që parashikojnë ndryshimin e ligjeve ekzistuese apo miratimin e ligjeve të reja, disa nga proceset e hartimit dhe miratimit të disa zgjidhjeve ligjore ende nuk kanë përfunduar,² kurse te disa shfaqen sfida sa i përket zbatimit të atyre që tashmë janë miratuar.³

Edhe pse gjatë dy viteve të fundit pandemia e COVID-19 ka ngadalësuar seriozisht procesin e përgjithshëm të reformës, këtë vit mund të thuhet se pandemia nuk pati një vrull të madh, kështu që arsyeja e mospërbushjes së aktiviteteve të planifikuara mund të jetë në natyrën e ligjeve, që kërkon një proces të kujdesshëm dhe gradual, për të shmangur miratimin e ligjeve jocilësore që për një kohë të shkurtër do të duhej të ndryshoheshin.

Ashtu si në vitet e kaluara, edhe këtë vit, për të siguruar monitorim të pavarur dhe objektiv të këtyre proceseve, *grupi Blueprint për reformat në sistemin e drejtësisë*⁴ në kuadër të projektit „*Për drejtësi - kontributi qytetar në avancimin e drejtësisë*“, i mbështetur financiarisht nga Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni, kryen monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të *Strategjisë*. Konstatimet nga monitorimi publikohen në raportet e monitorimit, ndërsa konstatimet nga vlerësimi i viteve të kaluara janë prezantuar në raportet vjetore hije për zbatimin e *Strategjisë*. Duke marrë parasysh se viti 2022 është viti i fundit i procesit të zbatimit të saj, konstatimet nga vlerësimi i viteve të kaluara si dhe nga ky vit do të kombinohen në një analizë me një vlerësim gjithëpërfshirës të zbatimit të *Strategjisë*.

1 I disponueshëm në: https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Strategjia%20i%20akciski%20plan_MK-web.pdf

2 Kodi Penal, Ligji i Procedurës Penale, Ligji i Procedurës Civile, Ligji për Drejtësi të Fëmijëve, etj.

3 Sidomos në lidhje me zbatimin e disa dispozitave të Ligjit për Prokurorinë Publike, Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ligjit për ndihmë juridike falas.

4 Grupin Blueprint për reformat në sektorin e drejtësisë e përbëjnë: Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, Instituti për Politikë Evropiane, Instituti për të Drejtat e Njeriut, Koalicioni -Të gjithë për gjykim të drejtë, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni.

Qëllimi i kësaj analize gjithëpërfshirëse dhe në përgjithësi të monitorimit është të vlerësojë nëse, në çfarë mase dhe në çfarë mënyre po zhvillohet procesi i zbatimit të Strategjisë në të gjithë periudhën për të cilën është parashikuar. Monitorimi ka për qëllim veçanërisht të përcaktojë nëse zbatimi i Strategjisë është në kohë, a është transparent dhe gjithëpërfshirës, dhe nëse ligjet dhe masat e miratuara janë të përshtatshme dhe kontribuojnë në arritjen e qëllimeve për të cilat janë planifikuar, si dhe të bëhet vlerësimi i ndikimit të reformave në respektimin e të drejtave të njeriut, realizimin e parimit të shtetit të së drejtës dhe drejtësisë sociale. Së fundi, analiza do të përmbajë gjithashtu rekomandime për zhvillimin e strategjisë së re të reformës në sektorin e drejtësisë – një proces në të cilin grupi Blueprint do të përfshihet me përfaqësuesit e tij në grupin e punës.

Objekt i monitorimit janë aktivitetet dhe masat specifike nga Strategjia që parashikojnë hartimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjeve ekzistuese ose miratimin e ligjeve krejtësisht të reja. Secila prej këtyre aktiviteteve legjislative që janë objekt i monitorimit i nënshtrohen analizës përmes prizmit të: pjesëmarrjes së palëve të interesuara (përfshirje në proces), transparencës, afatit kohor (duke monitoruar afatin kohor të parashikuar në Planin e veprimit të Strategjisë), cilësisë së zgjidhjeve ligjore të propozuara, si dhe ndikimit të tyre mbi të drejtat e njeriut dhe drejtësinë sociale.

Masat dhe aktivitetet e tjera që kanë të bëjnë me fuqizimin e institucioneve të drejtësisë në aspektin e burimeve njerëzore, aspektin teknik dhe financiar janë analizuar në raportet vjetore hiqe mbi zbatimin e Strategjisë dhe do të përfshihen në analizë me një vlerësim gjithëpërfshirës të zbatimit të Strategjisë.

Qasja kërkimore-hulumtuese përfshin një kombinim të mbledhjes dhe analizës së të dhënave. Mbledhja e të dhënave bëhet duke hulumtuar të dhënat e disponueshme publike dhe duke parashtruar kërkesa për qasje falas në informacionin me karakter publik. Analiza bëhet përmes një kuadri treguesish që përfshin tregues për: gjithëpërfshirjen, transparencën, afatin kohor, cilësinë dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

STATUSI I ZBATIMIT TË AKTIVITETEVE⁵

LIGJI	STATUSI
Ligji për ndërmjetësimin	Miratuar nga Kuvendi i Maqedonisë së Veriut në dhjetor 2021
Ligji për procedurën penale	Projektligji është në proces përgatitjeje nga grupi i punës nga prilli i vitit 2021
Ligji për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale	Miratuar nga Kuvendi i Maqedonisë së Veriut në prill 2021
Ligji për avokatinë	Projektligji është në procedurë parlamentare nga gushti i vitit 2021
Ligji për procedurën civile	Projektligji është në procedurë parlamentare nga gushti i vitit 2021
Ligji për drejtësi të fëmijëve	Projektligji është në proces përgatitjeje nga grupi i punës nga shtatori i vitit 2019
Kodi penal	Projektligji është publikuar në ENER në korrik 2022
Ligji për kompensimin monetar të viktimave të veprave penale	Projektligji është në procedurë parlamentare nga gushti i vitit 2021
Ligji për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë	Projektligji është në procedurë parlamentare nga qershori i vitit 2021

⁵ Statusi për zbatimin e masave përditësohet paralelisht me përgatitjen e këtij raporti monitorues.

* Përbajtja është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe përftuesit të grantit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur-Maqedoni.

I. Pjesëmarrja (Përfshirja)

TREGUESI: PËRFSHIRJA DHE
PJESËMARRJA E TË GJITHË PALËVE
TË INTERESUARA (SHTETËRORE DHE
JOSHTETËRORE), EKSPERTËT, KOMUNITETI
SHKENCOR DHE SHOQËRIA CIVILE NË
PROCESIN E HARTIMIT, MIRATIMIT DHE
ZBATIMIT TË NJË MASE SPECIFIKE

Ashtu si në vitet e mëparshme, ligjet e monitoruara nga ana e Platformës Blueprint në gjysmën e parë të vitit 2022 janë hartuar kryesisht nga grupet e punës të drejtuara nga Ministria e Drejtësisë. Struktura dhe përbërja e grupeve të veçanta të punës pasqyrojnë në një masë të konsiderueshme specifikat e çështjes që është objekt rregullimi. Shembull i mirë i përfshirjes së përfaqësuesve të profesioneve të caktuara për të cilat u referohen ligjet është hartimi i Ligjit për avokatinë, në përgatitjen e draftit të të cilit morën pjesë dhe dhanë kontribut të konsiderueshëm edhe përfaqësues nga Oda e Avokatëve të Maqedonisë së Veriut, përfaqësues nga Gjykata Themelore Penale Shkup dhe disa zyra të caktuara të avokatisë.

Një tregues i mirë i përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në këto procese është fakti se organizatat që janë pjesë e platformës Blueprint kanë marrë pjesë pothuajse në të gjitha grupet e punës për ligjet që janë analizuar, përveç Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar në çështjet penale. Megjithatë, përsëri theksojmë se mungon një model i strukturuar për pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në grupet e punës në fushën e gjyqësorit (Kodi penal, Ligji për procedurën penale, Ligji për procedurën civile dhe Ligji për drejtësi të fëmijëve), i cili do të mundësonte kontributin brenda afateve kohore në procesin e hartimit të ligjeve.

Sigurisht që platforma Blueprint dhe organizatat që janë pjesë e saj vazhdojnë të bashkëpunojnë dhe rrjetëzohen me organizata të tjera të shoqërisë civile dhe rrjete tematike, duke dhënë kështu kontributin e tyre në këto procese dhe më tej.

Format e përfshirjes në pjesën më të madhe janë zbatuar në përputhje me parimet e Udhëzuesit⁶ dhe metodologjinë⁷ për mënyrën e veprimit në punën e ministrive në procesin e zbatimit të vlerësimit të ndikimit të rregullores/legjislacionit. Megjithatë, në grupet e punës ka mungesë të përfaqësuesve të grupeve të marginalizuara dhe vulnerabël të qytetarëve dhe/ose organizatave të shoqërisë civile që përfaqësojnë interesat e tyre, që është një nga treguesit në fushën e pjesëmarrjes (përfshirjes), të cilin platforma Blueprint është duke e monitoruar.

Grupet e punës, veçanërisht personat kompetentë që i udhëheqin, më së shumti marrin parasysh komentet dhe propozimet e dorëzuara nga palët e interesuara dhe japin një arsytim thelbësor për arsyet pse ato nuk janë pranuar. Megjithatë, kjo nuk është praktikë e të gjitha grupeve punuese, si për shembull grupet punuese që kanë punuar ose janë ende duke punuar në tekstin e Ligjit për kompensimin monetar të viktimave të veprave penale dhe Ligjit për drejtësi të fëmijëve.

Gjithashtu, theksohet se mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet që nuk janë pranuar me shpjegimin e arsyeve nuk janë publikuar publikisht në faqen e internetit www.ener.gov.mk, në raportet për PVR, në kundërshtim me nenin 25 të Udhëzimit, siç është rasti me Ligjin për avokatinë.

6 Udhëzues për mënyrën e veprimit në punën e ministrive në procesin e zbatimit të vlerësimit të ndikimit të rregullores. I disponueshëm në: https://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/pvr/Upatstvo%20za%20PVR%20106-13.pdf

7 Metodologjia për vlerësimin e zbatimit të rregullores. E disponueshme në: https://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/Ex_post_Metodologjia.pdf



II. Transparenca

TREGUESI: PARIMI I QASJES PUBLIKE, HAPJES DHE DISPONUESHMËRISË SË INFORMACIONIT LIDHUR ME PROCESET

Sipas Udhëzimit për mënyrën e veprimit në punën e ministrive në procesin e zbatimit të vlerësimit të ndikimit të rregullores (VNRR), palët e interesuara informohen për proceset e hartimit të projektligjeve përmes një plani vjetor për VNRR, ku renditen projektligjet që do të punohen, dhe njoftimi i cili publikohet në ENER, si dhe përmes njoftimit për fillimin e përgatitjes për secilin ligj në veçanti. Njoftimi në kohë është veçanërisht i rëndësishëm për të siguruar kohë të mjaftueshme për palët e interesuara për të dhënë kontribut thelbësor dhe përmbajtësor në proces.

Ministria e Drejtësisë publikoi në ENER⁸ Planin Vjetor për VNRR për vitin 2022, i cili përmban disa nga ligjet që monitoron platforma Blueprint: Projektligjin për procedurën penale, Projektligjin për drejtësi të fëmijëve dhe Projektligjin e Kodit penal. Në vlerësimin e ndikimit të rregullores për Projektligjin për procedurë penale, si një objektivi i projektligjit është që institucionet kompetente të veprojnë në mënyrë më efektive në procedurën penale, kurse janë konstatuar edhe disa mangësi në zbatimin e Ligjit dhe është e nevojshme që të

bëhet harmonizimi i ligjit me legjislacionin evropian, përmes inkorporimit të direktivave të BE-së. Korniza kohore për zbatimin e VNRR-së dhe për zbatimin e konsultimeve është përcaktuar nga data 01.06.2022 deri më 30.06.2022, kurse palët e interesuara që do të përfshihen në proces janë prokuroritë publike, gjykatat, organet e administratës shtetërore, komunitetit akademik, nëpërmjet pjesëmarrjes në grupet e punës të formuara nga ministria ose Qeveria.⁹ Në VNRR për Projektligjin për drejtësi të fëmijëve, objektivi i projektligjit është të përcaktojë parimin e interesit më të mirë të fëmijës në nenin 3 të Projektligjit, të përmirësojë kuadrin ligjor për drejtësi të fëmijëve në mënyrë që të respektohet shprehimisht parimi i interesit më të mirë të fëmijës, transpozimi i direktivave të BE-së në lidhje me mbrojtjen procedurale të fëmijëve të dyshuar ose të akuzuar në procedimet penale dhe vendosja e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të veprave penale, unifikimi i sistemit të ndihmës juridike për fëmijët në të gjitha dispozitat e Projektligjit dhe forcimin e mbrojtjes së fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë në procedurë penale. Sa i përket problematikave, është evidentuar mungesa e një kuadri ligjor të përmirësuar për të drejtat e fëmijës, gjë që ndikon në realizimin jo të plotë të interesit më të lartë të fëmijës si parim bazë i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës, e cila çon në një zbatim të pabarabartë të dispozi-

8 | I disponueshëm në: <https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pvrAdm&subitem=pubpvrview&year=2022&comp=NtcPqcnxOjmd6yniK+zzFw==&reclId=49uX+ND6U-A7exLc7d1Y6mw==%22>

9 | I disponueshëm në: <https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pvrAdm&subitem=view&reclId=tFSNMDZnJKuRuvx7NG64Kw==>

tave për ndihmën juridike ndaj fëmijës që ndikon në realizimin jo të plotë të së drejtës për ndihmë juridike ndaj fëmijës. Mangësitë e tjera të përcaktuara janë mosrealizimi i interesave më të mira të fëmijës në drejtim të mbrojtjes procedurale në proceset gjyqësore kundër një fëmije dhe mbrojtjen e fëmijëve viktime dhe dëshmitarë në proceset penale për shkak të mospërputhjes së këtyre dispozitave me direktivat e BE-së, si dhe rregullimi i pamjaftueshëm i mekanizmave për parandalimin e delikuencës së fëmijëve në nivel vendor dhe qendror, si dhe kornizës institucionale, materiale dhe funksionale të Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve. Korniza kohore për zbatimin e VNRR-së dhe për zbatimin e konsultimeve është përcaktuar nga data 01.03.2022 deri më 30.04.2022, kurse palët e interesuara që do të përfshihen në proces janë Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Punëve të Brendshme, ISH Enti për Veprimtari Sociale, Prokuroria Themelore Publike, Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve, Oda e Avokatëve të Maqedonisë së Veriut, Megjash, Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj dhe Qendra për Punë Sociale Shkup, përmes pjesëmarrjes në grupe punuese të formuara nga ministria ose Qeveria.¹⁰ Në VNRR-në për Projekt Kodin Penal, qëllimi i projektligjit është kodifikimi i rregulloreve jopenale në Kodin Penal dhe harmonizimi i tij me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, ndërsa problemet e evidentuara janë: veprat e parapara penale në ligje të veçanta, shpërndarja e veprave penale në një numër të madh ligjesh, disa prej tyre madje janë teknikisht të paqëndrueshme, duke marrë parasysh se diksioni i tyre korrespondon më shumë me natyrën e një kundërvajtjeje specifike

10 | disponueshëm në: <https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pvrAdm&subitem=view&reclId=YhR2/ug17NDkAn-movaGYlw==>

sesa me natyrën e një vepre penale; shpërndarja e veprave penale në një numër të madh ligjesh sjell vështirësi në zbatimin e tyre, si nga ana e prokurorëve publikë ashtu edhe nga gjyqtarët. Korniza kohore për zbatimin e VNRR-së dhe për zbatimin e konsultimeve është përcaktuar nga data 01.05.2022 deri më 30.06.2022, kurse palët e interesuara që do të përfshihen në proces janë prokuroritë publike, gjykatat, organet e administratës shtetërore, komunitetit akademik, nëpërmjet pjesëmarrjes në grupet e punës të formuara nga ministria ose Qeveria.¹¹

Për numrin më të madh të ligjeve, njoftimet e ENER publikohen me kohë, paralelisht me procesin kur fillon puna e grupit të punës. Megjithatë, në rastin e disa ligjeve (Ligji për avokatinë dhe Ligji për procedurën civile), njoftimi për fillimin e procesit publikohet disa ditë para se të publikohet projektligji, gjegjësisht shumë më vonë se fillimi i procesit. Duke marrë parasysh se Ministria e Drejtësisë, si rregull, i publikon njoftimet në kohë, kjo përbën një përjashtim që nuk e vë në dyshim përshtypjen e përgjithshme për gjithëpërfshirjen e proceseve për hartimin e këtyre dy ligjeve. Gjithashtu, përmes grupit punues dhe kërkesës për mendime dhe propozime, tashmë është njoftuar edhe opinionin profesional se do të fillonte procesi. Në këtë pjesë është e rëndësishme të theksohet nevoja që planet strategjike të Ministrisë të jenë në përputhje me Strategjinë, si një nga mënyrat për rritjen e transparencës.

11 | disponueshëm në: <https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pvrAdm&subitem=view&reclId=3B+69RrBZt00eH-Rj0j8W/A==>

* Përbajtja është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe përfutuesit të grantit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur-Maqedoni.

Në parim, të gjitha ligjet që janë bërë në formë të projektligjeve janë publikuar në ENER, gjë që ka lënë mundësi edhe për komentimin e tyre. Përjashtim nga kjo është Ligji i ri për ndërmjetësim¹², i miratuar nga Kuvendi i Maqedonisë së Veriut në dhjetor të vitit 2021, i cili asnjëherë nuk u publikua në ENER. Para miratimit të ligjit të ri, në ENER për herë të fundit është publikuar versioni i Projektligjit për ndërmjetësim i vitit 2018¹³, i cili edhe pse kishte hyrë në procedurë, nuk ishte miratuar nga përbërja e mëparshme parlamentare. Raporti mbi VNRR-në dhe të gjitha komentet e publikuara në ENER i referohen Projektligjit të publikuar në vitin 2018, megjithëse ka disa dallime thelbësore ndërmjet dy versioneve që duhej domosdoshmërisht të publikoheshin më herët. Teksti i Ligjit të ri për ndërmjetësim është publikuar në ENER në mesin e korrikut së bashku me raportin për VNRR-në¹⁴, gati shtatë muaj pas miratimit të tij nga Kuvendi, gjë që e bën procesin e konsultimit të vonuar dhe të pakuptimtë në këtë rast.

Në mënyrë identike, Projektligji për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, i cili është dorëzuar në Kuvend në korrik të vitit 2021, nuk është publikuar në ENER, pra versioni i fundit i disponueshëm i ENER-it është teksti i projektligjit për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, të miratuar nga Qeveria në korrik të vitit 2019.¹⁵

12 Ligji për ndërmjetësim, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr: 294/2021 i datës 27.12.2021, <https://www.slvesnik.com.mk/issues/347ca6fd31344c17b-804dab7b326c226.pdf>

13 Projektligji i publikuar në ENER është i datës 15.10.2018.

14 Teksti i ligjit dhe raporti për VNRR-në janë publikuar në ENER më 12.07.2022.

15 Projektligji i publikuar në ENER është i datës 12.05.2019.

III. Afati kohor

TREGUESI: ZBATIMI I PROCESEVE BRENDA AFATIT TË PLANIFIKUAR KOHOR

Ashtu si në vitet e kaluara, vërehet një devijim nga afatet e planifikuara për zbatimin e masave në të gjitha ligjet që janë objekt monitorimi. Për të korrigjuar afatet joreale të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë, këto afate tashmë janë rishikuar. Arsyeja për këtë është fakti se reformat e planifikuara për t'u zbatuar janë të thella dhe kërkojnë kohë dhe përpjekje të konsiderueshme, shumë më tepër se sa ishte planifikuar fillimisht. Kjo është veçanërisht e dukshme në disa procese që kanë filluar shumë kohë më parë dhe nuk kanë përfunduar ende, sepse janë ngecur në një procedurë parlamentare që zgjat shumë (Ligji për procedurën civile, Ligji për avokatinë, Ligji për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë). Ndonëse devijimi i afateve nuk paraqet një lëshim që mund të vërë në pikëpyetje procesin e reformës, gjithsesi tregon nevojën për planifikim të kujdesshëm dhe realist të kornizës kohore të nismave të ardhshme reformuese që do të trajtohen në Strategjinë e ardhshme.

IV. Cilësia

TREGUESI: RREGULLORJA/AKTI E RREGULLON MATERIE NË MËNYRË MJAFT PRECIZE, TË QARTË DHE TË PADISKUTUESHME DHE MUNDËSON PËRMBUSHJEN E QËLLIMEVE PËR TË CILAT BËHET REFORMA

Duke pasur parasysh se shumica e tyre janë projektligje, përbajtja përfundimtare e të cilave është ende e paqartë, vlerësimi i cilësisë së tyre duhet të bëhet me shumë kujdes dhe me një dozë rezerve. Në këtë drejtim, grupi Blueprint gjatë kohës së monitorimit fokusohet në dy tregues që i referohen cilësisë së zgjidhjes ligjore të ofruar, qartësisë, saktësisë dhe specifikës së neneve, si dhe përshtatshmërisë së zgjidhjes ligjore për të arritur qëllimin për të cilin ajo është miratuar.

Shembull i mirë i nevojës për një tekst krejtësisht të ri të ligjit është Kodi Penal¹⁶, ku bëhen ndryshime serioze në renditjen e dispozitave dhe shtohen vepra të reja penale, prandaj kjo zgjidhje është më e mirë se sa t'i afrohet ndryshimit të Kodit Penal ekzistues. Në projektligjin e publikuar, mund të vërehen ndryshime në lidhje me veprat penale kundër mjedisit jetësor dhe futja e disa veprave të reja penale, përfshirë edhe veprën Ekocid. Përveç kësaj, janë bërë ndryshime dhe janë futur akte të reja penale në përputhje me Konventën e

16 Projektligji është publikuar në ENER më 07.07.2022.

* Përbajtja është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe përftuesit të grantit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur-Maqedoni.

Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, por ende nevojiten ndryshime për të qenë në përputhje të plotë me Konventën. Një vepër e re penale Drejtimi i automjetit nga pakujdesia është futur pas reagimeve të shumta të opinionit dhe publikut profesional gjatë vitit të kaluar. Gjithashtu, për shkak të ndryshimeve të rëndësishme, është hartuar një tekst krejtësisht i ri i Ligjit për procedurë civile dhe Ligjit për drejtësi të fëmijëve, për të lehtësuar zbatimin e tyre dhe për të arritur cilësinë nomoteknike të ligjit. Megjithatë, për këto dy tekste ende nuk mund të pretendohet me siguri se qëllimet për të cilat po bëhet ndryshimi janë arritur, duke qenë se në lidhje me Ligjin për drejtësi të fëmijëve në ENER-it, në njoftimin për fillimin e procesit, janë renditur 5 qëllime, është renditur vetëm një direktivë për të cilën kërkohet pajtueshmëri dhe thuhet se kërkohet respektimi i Ligjit për procedurë penale, i cili është në proces të ndryshimit dhe plotësimit, dhe nga ana tjetër është i nevojshëm zbatimi i Ligjit për procedurë civile për të qenë në gjendje të përcaktojmë nëse do të arrihen objektivat duke marrë parasysh që Plani i Veprimit i përcakton ato në mënyrë shumë abstrakte (“tejkalimi i problemeve gjatë zbatimit të tij”). Përderisa përgatitja e një teksti të ri justifikohet në këto ligje, nevoja për një tekst të ri nuk vërehet në Ligjin për avokati dhe Ligjin për ndërmjetësim, në të cilët nuk janë bërë ndryshime të mëdha, megjithëse është duke u miratuar një tekst i ri ligjor, e cila ngre sërish pyetjen nëse është e justifikuar miratimi i një ligji të ri me ndërhyrje të vogla në përmbajtjen e tij.

Treguesi i dytë - përshtatshmëria e zgjidhjes ligjore të përmbushë qëllimet e përcaktuara për të cilat është miratuar - është më kompleks për t’u vlerësuar për shkak të qëllimeve të përcaktuara në mënyrë të pasaktë sipas mënyrës së parashikuar në Strategji. Për shembull, në rastin e Ligjit për procedurën civile, motivi fillestar për miratimin e një Ligji krejtësisht të ri ishte përmirësimi i dispozitave që “shkaktonin probleme dhe vështirësi të konsiderueshme në praktikë” pa specifikuar konkretisht në cilat fusha. Në rastin e Ligjit për avokatinë, nga ana tjetër, Strategjia parasheh “futjen e trajnimeve të vazhdueshme për avokatët, të organizuar nga Oda e Avokatëve, me një fond ligjor të orëve në nivel vjetor”, kurse projektligji i miratuar vetëm pjesërisht e përmbush këtë qëllim, për arsye se nuk parashikon numrin minimal ligjor të orëve që avokatët do të duhej të kalonin në trajnim. Nga ana tjetër, mund të konstatohet se Ligji i ri për ndërmjetësimin i përmbush qëllimet për të cilat është miratuar, sepse rishikon provimin për ndërmjetësues, parasheh mundësinë e fillimit të procedurës së ndërmjetësimit në mënyrë elektronike dhe prezanton regjistrimin/futjen e detyrueshme të të gjitha kërkesave të pranuar për ndërmjetësim në Regjistrin Elektronik dhe prezantohet poashtu edhe themelimi i Këshillit Kombëtar të Ndërmjetësimit.

V. Ndikimi mbi të drejtat e njeriut dhe drejtësinë sociale

TREGUESI: PROJEKTLIGJI/RREGULLORJA LEHTËSON REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË BARTËSVE TË TË DREJTAVE (RIGHTS-HOLDERS) DHE FORCON PËRGJEGJËSINË E BARTËSVE TË DETYRIMEVE (DUTY-BEARERS)

Në këtë fazë, një vlerësim i ndikimit të ligjeve të propozuara mbi të drejtat e njeriut dhe drejtësinë sociale mund të bëhet vetëm me një dozë rezerve. Megjithatë, nga aspekti i përmbajtjes së disa ligjeve, si dhe nga proceset e përgatitjes dhe miratimit të tyre, mund të bëhet një analizë fillestare për fushat dhe mënyrën se si ato mund të kenë ndikim në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Projektligji për procedurën civile, si ligj qendror që do të rregullojë veprimet dhe punën e gjykatave, mund të ketë ndikim të rëndësishëm në ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave. Ligji për procedurën civile duhet të ofrojë garanci për barazinë e armëve. Nga ana tjetër, parimi i efikasitetit procedural mund të ndikojë negativisht në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Shkurtimi i afateve në të cilat duhet të ndërmerren veprime të caktuara procedurale, si dhe pasojat e rënda nga mungesa e nisjes së veprimeve të caktuara, mund të jenë një sfidë serioze për personat që nuk kanë akses në ndihmën juridike cilësore.

Risitë e rëndësishme që pritet të kenë ndikim pozitiv janë: ulja e masës së gjobës për pjesëmarrësit në procedurë, vendosja e një procedure të veçantë për mbrojtjen e të drejtave kolektive (mbrojtja e mjedisit jetësor, parandalimi i diskriminimit, të drejtat e konsumatorit, të drejtat shëndetësore dhe interesa të tjera), heqja e detyrimit për të parashtruar ekspertizës së bashku me padinë, si dhe e drejta e paraparë e rishikimit në kontestet për mbrojtjen nga diskriminimi dhe në kontestet për ngacmim psikologjik në vendin e punës (mobingu).

Ligji për procedurën civile ka një rol veçanërisht të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave pronësore të qytetarëve, sepse vendos kornizën në të cilën zgjidhen mosmarrëveshjet pronësore dhe familjare, si dhe çështjet që lidhen me borxhet. Një kuadër ligjor që favorizon kompanitë dhe individët në një pozitë materiale më të favorshme në krahasim me palët më të varfra dhe injorante ligjërisht, mund ta vështirësojë ndjeshëm aksesin në gjykatë dhe në këtë mënyrë të ketë efektin e forcimit të rrethit vicioz të varfërisë. Zgjidhja e propozuar ligjore parashikon që përjashtimi nga pagesa e shpenzimeve të procedurës, për ata që nuk janë në gjendje t'i paguajnë ato financiarisht, do të kalojë plotësisht për t'u rregulluar me dispozitat e Ligjit për ndihmë juridike falas.

* Përmbajtja është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe përftuesit të grantit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur-Maqedoni.

Projektligji për drejtësi të fëmijëve, i cili është ende në versionin e punës, nëse ngritet sistemi për avokatin dhe shpenzimet e avokatit të paguhen nga autoriteti para të cilit trajtohet fëmija (Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Prokuroria Publike), ekziston mundësia e lehtësimit të procesit të realizimit të të drejtave të fëmijës. I vetmi rrezik që mund të lindë është që autoritetet si bartës të detyrimeve që marrin pjesë në proceset e trajtimit të fëmijës të mos ndihen mjaftueshëm të detyruara për të paguar shpenzimet e ndihmës juridike, kështu që kjo do të ndikonte në cilësinë e ndihmës juridike dhe mungesën e interesit të mjaftueshëm për pjesëmarrje të mëtejshme në sistemin e drejtësisë për fëmijët të këtij shteti. Duke u nisur nga fakti se deri më tani kishte një boshllëk në legjislacionin vendas në përcaktimin e termit “interesi më i mirë i fëmijës”, ndonëse disa herë është theksuar se kjo duhet kapërcyer, ky ligj e arrin pikërisht këtë. Përfshihet një përkufizim i tillë, i cili në vetvete nënkupton se aksesit i fëmijës në drejtësi pritet të përmirësohet në drejtim të prioritizimit të tij ndaj interesave të tjera, dispozitave materiale dhe/ose procedurale.

Për shkak të natyrës së Ligjit për avokatinë, i cili rregullon çështjet statusore për një profesion të caktuar, ndikimi i tij te bartësit e të drejtave dhe bartësit e detyrimeve, si dhe në lehtësimin e qasjes në drejtësi, është i kufizuar. Megjithatë, vendosja e një detyrimi për edukim të vazhdueshëm (duke supozuar se do të kryhet me standardet më të larta) mund të sigurojë një cilësi më të mirë të ndihmës juridike, e cila është e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të bartësve të të drejtave. Gjithashtu, futja e trajnimit fillestar të detyrueshëm duke u fokusuar në rregullat etike të pro-

fesionit pritet të ketë një ndikim pozitiv në qëndrimin e avokatëve ndaj palëve vulnerabel. Në të njëjtën kohë, Projektligji për avokatinë vendos një kufizim kohor për aksesin në profesion (punë) për kategori të caktuara personash për të cilët ka një funksion të caktuar publik të përcaktuar me ligj (p.sh. gjyqtari, prokurori publik, etj.) që iu është ndërprerë nga një procedurë gjyqësore, disiplinore ose një procedurë tjetër, me të cilën përcaktohet përgjegjësia në ushtrimin e funksionit, megjithëse Kodi Penal nuk parashikon ndalim të ushtrimit të profesionit. Megjithatë, kufizimi është i justifikuar dhe ka një qëllim legjitim, që është mbrojtja e integritetit dhe reputacionit të profesionit të avokatit.

Ligji i ri për ndërmjetësimin sërish parasheh mundësinë e subvencionimit të procedurave të ndërmjetësimit dhe rregullon kushtet dhe kriteret e përgjithshme për subvencionimin e shpenzimeve të ndërmjetësuesit, ndërsa kriteret më të përafërta dhe mënyrën e subvencionimit i ka përcaktuar Ministri i Drejtësisë, me miratimin e Rregullores për kriteret më të afërta, mënyrën e subvencionimit, pagesën, formularin për shpërblimin e arkëtuar, shpenzimet e ndërmjetësuesit, formularin e kërkesës për subvencionim dhe dokumentacionin e nevojshëm që paraqitet krahas kërkesës për subvencionimin e një pjese të kostove të ndërmjetësimit.¹⁷

17 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr: 91/2022 e datës 12.04.2022.

Progres i dukshëm në lidhje me këtë tregues është bërë me Ligjin për kompensimin monetar të viktimave të veprave penale, i cili kaloi leximin e parë në Kuvend në korrik të vitit 2022 dhe është ende në procedurë parlamentare. Konkretisht, ligji është hartuar me qëllim që të plotësojë nevojat e viktimave të veprave të dhunshme penale që nga ndihma fillestare në trajtimin e pasojave të përjetuara të një veprë të dhunshme penale. Ligji parashikon themelimin e një organi të pavarur të quajtur Komisioni për dëmshpërblimin monetar të viktimave të veprave të dhunshme penale. Në këtë komision do të ishin të bashkuar përfaqësuesit e të gjithë aktorëve kryesorë që merren me viktimat, të cilët kanë për obligim të kryejnë aktivitete për sensibilizimin dhe informimin e publikut dhe të viktimave për realizimin e të drejtave të parashikuara nga ky ligj.

Nëse respektohet parimi i barazisë dhe jo selektivitetit gjatë zbatimit të ligjit në praktikë, pritjet të përmirësohet qasja në drejtësi për viktimat e krimeve të dhunshme, të cilat përfaqësojnë një kategori të cënueshme të personave. Rrjedhimisht, përmes llojeve të dëmshpërblimeve monetare të parashikuara në ligj, pritjet që viktima të ndihmohet duke forcuar sigurinë e saj/tij financiare për ballafaqimin më të lehtë të pasojave të veprave penale.

RRETH PROJEKTIT

Projekti “Për drejtësi - kontribut i qytetar në avancimin e drejtësisë” mbështetet financiarisht nga Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni, dhe zbatohet nga Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, Instituti për Politikë Evropiane, Instituti për të Drejtat e Njeriut, Koalicioni - Të gjithë për gjykim të drejtë, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike, nën koordinimin e Institutit për Politikë Evropiane.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është rritja e ndikimit të organizatave të shoqërisë civile në procesin e reformës në drejtësi si parakusht për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sigurimin e drejtësisë sociale.

Objektivat e veçanta të projektit janë:

1. **Forcimi i procesit të monitorimit të zbatimit të Strategjisë për reformën e sektorit të drejtësisë (2017-2022) me fokus në ndikimin e saj në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sigurimin e drejtësisë sociale, si dhe kontributin në përgatitjen e Strategjisë së ardhshme për sektorin e drejtësisë.**
2. **Avancimi i politikëbërjes me pjesëmarrje në fushën e drejtësisë duke përdorur një qasje ndërsektoriale dhe bashkëpunim me rrjetet tematike dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile.**
3. **Forcimi i aktiviteteve avokuese bazuar në dëshmitë në fushën e drejtësisë nga organizatat e shoqërisë civile.**

* Përbajtja është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe përftuesit të grantit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur-Maqedoni.

